



SYLLABUS

Lënda: Retorika dhe shprehjet juridike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Retorika dhe shprehjet juridike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i I-të, semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	4
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: e premte, prej 12:30 - 14:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Ligjerues: Dr.sc. Flamur Hyseni
Detajet kontaktuese:	flamur.hyseni@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Retorika dhe shprehjet juridike është disiplinë e re në kuadër të studimit tëshprehjeve juridike përmes retorikës. Në Kosovë është lëndë e re, por edhe në rajon. Orët e para do ia kushtojmë retorikës, kuvendimit dhe paraqitjes publike, ku do të flitet lidhur me raportin e retorikës dhe të kuvenduarit, pastaj do flasim lidhur me kuvendimin dhe talentin, kuvendimin si mjeshtri dhe si art, e më vonë do flasim lidhur me të kuvenduarit dhe zanafilën e retorikës. Në këtë pjesë do të flitet për demokracinë dhe fjalën e lire, demagogjinë dhe fjalimet jot ë mira (mantra)dhe, natyrisht do të bëjmë fjalë lidhur me tre segmente të retorikës të cilat e bëjnë një fjalim të jetë I pranuar, I nivelit të dëshiruar, pra, do flasim për Logos, Ethos dhe Pathos. Të gjitha këto bëjnë pjesë në pjesën e parë të ligjeratave. Në pjesën e dytë do bëhet fjalë lidhur me mësimet nga historia e retorikës dhe të kuvenduarit, ku do ligjërojmë lidhur me Mrekullit greke – me djepin e retorikës, do flasim lidhur me Retorikën dhe paraqitjen e saj në Greqi, Lidhjet e të drejtës dhe të kuvenduarit – logografët, do flasim lidhur me kuvendarët e njohur, siç janë DEMOSTENI, CICERONI (Marko Tuli Ciceroni), Kvintilijani, do flitet natyrisht për Sokratin, Platonin, Aristotelin e të tjerë.
Qëllimet e lëndës:	Studentët do të njihen me zanafilën apo origjinën eretorikës

	apo të biseduarit që nga koherat më të herëshme gjer në ditët e sotme. Do të njihen pra me historikun e zhvillimeve të të biseduarit dhe të kuvenduarit nepër vende të caktuara siç janë sheshet e hapura, vendet e mbyllura të tipit të shkollave, të vendeve publike oficiele, në ndonjë konferencë shkencore apo simpoziuim e te tjera.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Synohet se të arrihet se studentët me përfundimin e ligjëratave dhe dhënies së provimit do të dinë të përgatitin një fjalim gjyqësor në mënyrë të pavarur, dhe do të mësojnë aplikimin e metodave diskutuese në mënyrë të pavarur.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4	1/15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/4	16
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	1/15	30
Kollokfiume,seminare	1	1	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimëdhënies do të jet standarte, duke aplikuar veçanëriusht metodën e interaktivitetit. Do të aplikohen edhe debatet dhe diskutimet në klasë, prezantimi i pounimeve nga studentët dhe diskutimi mbi çështjet e ndryshme aktuale politike dhe juridike.		
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: pikë Testi i dytë: pikë Detyrat e shtëpisë: pikë (detyra x pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: pikë Provimi përfundimtar: pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10		

	Pikët nën 50 nuk mbërrin në notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Osman Ismaili, Flamur Hyseni, RETORIKA (ligjërata të autorizuar), Prishtinë, 2015
Literatura shtesë:	<i>Stefan Lukas. Arti i të folurit publik, New York, 2008</i>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftim i studentëve me plan-programin e lëndës
<i>Java e dytë:</i>	Raportet e retorikës me të zhvilluarit e bisedimit
<i>Java e tretë:</i>	Talenti për të kuenduar
<i>Java e katërt:</i>	Kuvendimi si mjeshtri dhe art
<i>Java e pestë:</i>	Llojet e paraqitjes publike “Public speaking”
<i>Java e gjashtë:</i>	Demokracia dhe fjala e lirë
<i>Java e shtatë:</i>	Kolokviumi I
<i>Java e tetë:</i>	Demagogjia
<i>Java e nëntë:</i>	Rëndësia e fjalimit “Mantri” në retorikë
<i>Java e dhjetë:</i>	Fillet e para të paraqitjes së retorikës në antikë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kontributi i Demostenit në retorikë, studimi i fjalimeve të tij
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Si të keni paraqitje të sukseshme publike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Teknikat e komunikimit me publikun
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Analizim i fjalimeve të famshme publike
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokviumi i II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijueshmëria në ligjerata dhe ushtrime është obligative për të gjithë studentët e rregullt, përveq rasteve të arsyeshme të mungesës së raste të caktuara. Qetësia gjatë orës së ligjeratës apo ushtrimeve është esenciale në suksesin e lëndës andaj studentët duhet të mbajnë qetësinë në nivelin e duhur. Interaktiviteti gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve është pjesë e rëndësishme e mësimdhënies dhe të gjithë studentët janë të inkurajuar që të marrin pjesë në mënyrë aktive. andaj studentët të cilët kërkojnë që të inkuadrohen dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me temat e caktuara në kuadër të syllabusit të kësaj lënde mund të ngrisin dorën për të marrë fjalën. Kontakti me profesorin apo asistentin e lëndës mund të zhvillohet gjatë orëve të konsultimeve ose përmes emailit zyrtar.